

VENDIM
Nr.897, datë 21.12.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR SHPALLJEN E ZONAVE TË VEÇANTA TË RUAJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 4/3 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpallja e zonave të veçanta të ruajtjes (ZVR) të kryhet mbi bazën e kriterëve dhe vlerësimeve të përcaktuara në nenin 4/3 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe sipas rregullave që përcaktohen në këtë vendim.

2. Zona të veçanta të ruajtjes të shpallen ato territore që ndodhen në zonat e mbrojtura, brenda rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, si dhe ekosisteme, habitate e peizazhe jashtë këtij rrjeti, si më poshtë:

a) Zonat që kanë statusin e zonës Ramsar, si ligatina me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht për shpendët e ujit;

b) Zonat me rëndësi për shpendët;

c) Zonat me interes të veçantë ruajtjeje të identifikuar në kuadrin e zbatimit të konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (Konventa e Bernës), në të cilën Republika e Shqipërisë është palë, ratifikuar me ligjin nr.8294, datë 2.3.1998;

ç) Zonat që nuk bëjnë pjesë në rrjetin e zonave të mbrojtura apo në zonat e tjera, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të këtij paragrafi.

3. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, mbi bazën e të dhënave ekzistuese, harton një listë paraprake të zonave që potencialisht plotësojnë kriteret për t’u shpallur si ZVR. Lista paraprake e ZVR-ve i nënshtrohet vlerësimit të mëtejshëm, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

4. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve bashkërendon punën me institucionet kërkimore e universitare dhe njësitë e qeverisjes vendore për kryerjen e studimit, me qëllim vlerësimin e zonave potenciale për t’u shpallur zona të veçanta të ruajtjes. Mbi bazën e këtij studimi hartohet një listë paraprake e zonave që potencialisht plotësojnë kriteret për t’u shpallur si ZVR.

5. Rezultatet e vlerësimit dhe të dhënat për çdo zonë u nënshtrohen diskutimeve me publikun, në përputhje me parashikimet e vendimit nr.994, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrjen për mjedisin”.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave përgatit dokumentacionin për çdo zonë, në të cilin përfshihen edhe mendimet e siguruara dhe ia paraqet për mendim zyrtar ministrive të linjës, prefektëve dhe shoqatave të zgjedhurve vendorë dhe njësite të qeverisjes vendore.

7. Pas marrjes së mendimit nga ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore, ministri miraton, me urdhër, listën e zonave të veçanta të ruajtjes dhe së bashku me të dhënat përkatëse për çdo zonë, ia dërgon Komisionit Europian.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha